



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d), 17 shkronja b), 40.2 shkronja l) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 5 paragrafi 1.2.2, nenit 10 paragrafi 2.1, nenit 11 paragrafi 1.12 dhe nenit 20 të Ligjit nr.04/L-174 për planifikimin hapësinor, nenin 7 paragrafi 2, dhe 8 paragrafi 2, 4 si dhe 12 të Udhëzimit Administrativ nr.05/2014 (MMPH) për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikimin hapësinor, nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/2018 për Transparencë në Komuna, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, neneve 14 dhe 15 parag. 2.4 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, në pajtim me nenin 35 shkronja o), dhe 37 pika 4 të Rregullores së Komunës së Podujevës për mënyrat, procedurat dhe kushtet e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes nr.01/18-02 të datës 31 janar 2011, në zbatim të Planit të Veprimit për Transparencë për periudhën 2019 – 2023 në Komunën e Podujevës, Vendimit të Kuvendit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-948/03-0072034/17 dt.19.09.2017 për fillimin e hartimit të Hartës Zonale, Vendimit nr.prot.01-450/05-0063175/21 me të cilin autorizohet dhe obligohet Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së mjedisit për përgatitjen e plotësimit ndryshimeve të dokumentit të projekt Hartës Zonale të Komunës së Podujevës 2020-2028 i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më 30 korrik 2021, si dhe aktit të vlerësimit të përputhshmërisë nr.prot.SP-0271162-2/19 të datës 17.01.2021 të MMPH, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shtator 2021, miratoi këtë;

VENDIM PËR VËNIEN NË SHQYRTIM PUBLIK

Neni 1

Vëhet në shqyrtim publik;

- **Projekt Harta Zonale e Komunës së Podujevës (HZ) 2020-2028, me ndryshimet dhe plotësimet e hartuara nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM, konform Vendimit nr.prot.01-450/05-0063175/21 të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më 30 korrik 2021, dhe atë;**

- *Harta Zonale e Komunës, periudha 2021-2029*
- *Rishikimi i blloqeve dhe etazhëtetit në zonën urbane*
- *Rishikimi i dispozitës së projekt Hartës Zonale bazë, për përfshirjen e ndërtesave bujqësore në tokë bujqësore*
- *Rishikimi i kufirit të tokës ndërtimore në fshatrat përreth qytetit (për gjithsej 10 vendbanime)*
- *Rishikimi i koeficientit të ndërtimit në vendbanimet përgjatë rrugës Podujevë-Prishtinë (për gjithsej 12 vendbanime)*
- *Rishikimi i kufirit të zonës ekonomike*

Neni 2

1. Njoftimi publik për projekt Hartën Zonale të Komunës së Podujevës 2021-2029 bëhet së paku 8 (tetë) ditë para hapjes së shqyrtimit publik.
2. Shqyrtimi publik sipas nenit 1, zgjat 30 ditë dhe fillon nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
3. Shqyrtimi publik mbahet konform dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi, me theks *Udhëzimit Administrativ nr.05/2014 (MMPH) për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikimin hapësinor* dhe organizohet nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM e cila gjatë kësaj periudhe, ndër të tjera, prezanton pjesën grafike dhe tekstuale të ndryshimeve dhe plotësimeve projekt Hartës Zonale të Komunës së Podujevës.

Neni 3

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet lidhur me dokumentin në fjalë mund të paraqiten gjatë periudhës së shqyrtimit publik përmes debateve të drejtpërdrejta me qytetarë, në formë të shkruar në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit - ndërtesa e re e Komunës, sipas njoftimit publik, si dhe në formë elektronike në e-mail adresën; masar.qitaku@rks-gov.net; të cilat përcjellën në DPUMM brenda periudhës së shqyrtimit publik.

Neni 4

Dokumenti sipas nenit 1, përkatësisht projekt Harta Zonale e Komunës së Podujevës me plotësim ndryshimet e hartuara nga DPUMM, është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve> (rubrika; aktet për diskutim publik)

Neni 5

1. Shqyrtimin publik obligohet ta zbatoj Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, e cila po ashtu përgatitë raportin për shqyrtimin publik përkatës dhe jep sqarime dhe arsyeshmëri rreth pranimit ose mospranimit të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.
2. Gjatë periudhës së shqyrtimit publik sipas këtij vendimi, DPUMM bashkëpunon dhe koordinon me Zyrën për marrëdhënie me publikun dhe informim.

Neni 6

Pas përfundimit të shqyrtimit, DPUMM ndërmerr të gjitha veprimet e parapara ligjore për finalizimin e dokumentit të Projekt HZ-së, dhe procedimit të tij në Kuvendin e Komunës së Podujevës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, ndërsa anulohet Vendimi i Kuvendit të Komunës nr.prot.01-070/05-0056357/21 i datës 13 korrik 2021.

Nr.01-350/05-0085317/21
Podujevë,
27 shtator 2021



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi